

E DREJTA PËR INFORMIM

Indekset e transparencës proaktive



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale publikon për vitin e katërt radhazi, Raportet mbi “Indeksin e Transparencës së Autoriteteve Publike Qendrore dhe të Varësisë 2023” dhe “Indeksin e Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore 2023”. Këto indekse ndjekin një metodologji të caktuar, e cila shërben kryesisht për të sjellë një analizë krahasuese të nivelit të transparencës proaktive të autoriteteve publike, duke krahasuar trendin e transparencës së tyre ndër vite. Gjetjet e këtyre raporteve synojnë të nxisin ndërgjegjësimin për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit dhe rritjen e nivelit të transparencës përmes publikimit proaktiv të informacionit. Gjithashtu, indekset shërbejnë edhe si referencë përpara vendimmarrjes së Zyrës së Komisionerit në respektim të dispozitave ligjore.

Në konkluzion të monitorimit të autoriteteve publike gjatë vitit 2023, vërejmë një rritje të transparencës proaktive. Në raportet e publikuara, konstatohet rritje e numrit të autoriteteve publike të cilat kanë grumbulluar pikët maksimale dhe për këtë arsye janë klasifikuar me transparencë të lartë. Dy indekset mund të konsultohen në faqen zyrtare të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Vendimmarrja e Zyrës së Komisionerit

Vendim Nr. 2 - Bashkia Tepelenë

Vendim Nr. 3 - Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit janar 2024.



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit janar 2024, ka dhënë 2 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI"). Me vendim nr. 02, datë 09.01.2024, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj Autoritetit Publik "Bashkia Tepelenë" (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesi ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") formularin e ankesës, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare". Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion dokumentacioni dhe konkretisht:

- Lejen e përdorimit të burimit ujor nga "Këshilli i Basenit Ujor Vjosë" për burimin ujor të fshatit Mezhgoran lidhur me projektin e miratuar për ndërtimin e Ujësjellësit Mezhgoran Peshtan.
- Projektin e miratuar për Ujësjellësin Mezhgoran Peshtan.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak për ndërtimin e Ujësjellësit Mezhgoran Peshtan.
- Procesverbalet e konsultimit publik me banorët e fshatit Mezhgoran ku të jenë shënuar qartësisht mendimet dhe pretendimet e tyre.
- Një kopje të dokumentacionit të kompanive "2 T" dhe "GPC Company" në bazë të të cilit ato dy kompani kryejnë punime.

Pas verifikimit të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, si dhe parashtrimeve të dhëna nga Autoriteti Publik, Komisioneri konstaton se, lidhur me pikën e parë të kërkesës për informacion, Autoriteti Publik, ka sqaruar se: "...Lidhur me lejen për shfrytëzimin e burimeve ujore, ajo merret pasi përfundon vepra/objekti dhe uji vihet në shfrytëzim. Kjo në referencë të aplikimit për konformitet që i është dërguar Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU). Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se dokumentacioni i kërkuar nuk disponohet nga Autoriteti Publik dhe si rrjedhojë kjo kërkesë rrëzohet, pasi nuk përmbush kriteret e parashikuara në pikën të 2 të nenit 2 të LDI.

Për sa i përket pikës dy dhe tre të kërkesës për informacion, konstatohet se Autoriteti Publik ka publikuar dokumentacionin e kërkuar në faqen zyrtare. Bazuar në shkronjën "b" të pikës 2 të nenit 14 të LDI në të cilën parashikohet se: "Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit...një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet", Komisioneri vlerëson se, detyrimi për informim lidhur me këto dy pika të kërkesës për informacion, konsiderohet i përmbushur.

Lidhur me pikën katër të kërkesës për informacion, Autoriteti Publik ka sqaruar se: "Procesverbalet e konsultimit publik me banorët e fshatit Mezhgoran (të përfaqësuar me prokurë noteriale) mund t'i drejtohen Agjencisë Kombëtare të Mjedisit,

meqenëse është institucioni që organizon dëgjesat para se të lëshojë Lejen Mjedisore apo Vendim për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis". Komisioneri e gjen të pabazuar këtë argument, për shkak se Autoriteti Publik nuk rezulton që të ketë trajtuar kërkesën për informacion, në bazë të pikave 2 dhe 3 të nenit 12 të LDI.

Lidhur me pikën pesë të kërkesës për informacion, Komisioneri konstaton se, Autoriteti Publik nuk është shprehur, si dhe nuk provoi në asnjë moment, se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar në pikën katër dhe të pesë të kërkesës për informacion, në parim përbën informacion publik bazuar në pikën 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilës: "informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është gjepiluar ose jo nga Autoriteti Publik". Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: "Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit".

Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi, urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit, konkretisht për pikën katër dhe pesë të kërkesës, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.




**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

3 – 5 qershor 2024, Konferenca e 15-të Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit

Nëpërmjet komunikimit zyrtar dhe atij social, zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale shpalli datat e zhvillimit të Edicionit të 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (*International Conference of Information Commissioners*), që do të zhvillohet në Tiranë në datat 3-5 Qershor 2024.

Ky është aktiviteti më i rëndësishëm në nivel botëror për nxitjen e kulturës së transparencës dhe aksesit në dokumentat zyrtare.

Zyra e Komisionerit beson se kjo Konferencë do të shërbejë si një platformë për trajtimin e pikëpamjeve, sfidave dhe mundësive me partnerët e saj, me përfaqësues të botës akademike, organizatat e shoqërisë civile, të subjekteve mediatike, vendas e të huaj.



Ky aktivitet madhor, që mbahet për herë të parë në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, synon që t'i japë një shtysë konkrete avancimit në këtë fushë, për respektimin e kësaj të drejte themelore individuale, si një nga faktorët kryesorë për një shoqëri demokratike funksionale.

Për më shumë informacion mund të konsultoheni me faqen zyrtare dedikuar konferencës:

www.informationcommissioners2024.al

Bashkëpunim për transparencën e sistemit gjyqësor

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë në një takim të organizuar nga Zyra për Marrëdhëniet me Publikun pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm të Tiranës në kuadër të komunikimit transparent midis sistemit gjyqësor, publikut dhe medias. Në këtë aktivitet ishte e ftuar edhe znj. Besa Velaj, Drejtor i Kabinetit të Komisionerit, ndërsa ishin të pranishëm edhe përfaqësues të shoqërisë civile apo medias.

Takimi kishte në fokus të tij analizimin e veprimtarisë së kësaj gjykate në këndvështrim të përbushjes së detyrimeve që burojnë nga ligji për të drejtën e informimit dhe ai për mbrojtjen e të dhënave personale, diskutimin për forcimin e bashkëpunimit me partnerët në rritjen e efikasitetit të mekanizmave informues, si dhe në funksion të plotësimit të detyrimeve ligjore për Programin e Transparencës. Zyra e Komisionerit kontribuoi në këtë takim me trajtimin në balancë dhe proporcionalitet të çështjeve ku ndërvepron e drejta për informim dhe ajo për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve.



Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



[idp.albania](https://www.instagram.com/idp.albania)



[IDP Albania](https://twitter.com/IDPAlbania)



[Komisioneri KDIMP](https://www.youtube.com/KomisioneriKDIMP)